



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:209738

Datë: 11.03.2020

Numri i dokumentit: 00892033

P.nr.1005/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe asistentin Muedin Rexhepi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K nga fshati K. Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ë në Ferizaj PP/II nr.1605-4/19 të datës 20.09.2019, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Luljeta Bilalli, të dëmtuarit I.K si dhe të akuzuarit F.K, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 26.02.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2020 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: F.K, nga fshati ..., Komuna Ferizaj, i lindur me datën ... në fshatin Komuna Shtime, nga i ati A.... dhe nëna H... e vajzërisë L..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion arsimtar, i martuar, prindi i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon letërnjoftim me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 16.08.2019, rreth orës 12:50, në fshatin, Komuna Ferizaj, saktësisht në rrugën e fshatit i pandehuri ka shkaktuar dhunë në familje, ashtu që me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin-vëllain e tij I.K duke ju drejtuar me fjalët “se ka me të ngulur në tërfurk, ju jeni pisa dhe ka me ju ba hakaret”, me ç’rast kjo kanosje tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

me këtë ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së, të akuzuarin F.K e

G J Y K O N

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej 1 (një) Viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- I dëmtuari: I.K me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.
- Në bazë të nenit 450 par.1 dhe par.2 të KPPK-së, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë), në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, të ligjit Nr. 05/L-036 për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30€ /tridhjetë/ brenda afatit prej 30 ditëve nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1605-4/19 të datës 20.09.2019 kundër të akuzuarit F.K me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 24.10.2019 si dhe shqyrtimin gjyqësor me datë 04.02.2020 dhe 26.02.2020 në të cilat shqyrtime i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari F.K në shqyrtimin fillestar si dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I njëjti në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike me datë 16.08.2019 rreth orës 13:00 ka mbledhur mbeturinat në oborrin e shtëpisë së tij dhe të njëjtat me karrocë dore ku ka pas edhe një tërfurk në karrocë, i ka dërguar në një pjesë të fshatit, afër zyrës së vendit (zyra e vjetër) për ti djegur pasi aty i dërgojnë gjithë fshatarët dhe pasi i ka djegur ato mbeturina është nis në drejtim të shtëpisë dhe në rrugë afër shtëpisë ka parë I... duke dalë dhe të njëjtit ia ka drejtuar këto fjalë “kur të ecësh rrugës mos provoko dhe mos i mpsho askujt”, këto ia ka thënë pasi një ditë më parë në urë e cila gjendet afër shtëpisë ai e kishte goditur në anën e majtë të krahut dhe në këtë moment I... menjëherë i është drejtuar me fjalë të vrazhda dhe ton të lartë duke i thënë “ti je pis dhe fjalë të ndryshme banale” dhe të njëjtit vetëm i ka thënë “se krejt këto që po mi thua je ti vet” dhe ai ka vazhduar rrugën e tij ndërsa ky rrugën e vet dhe ka hyrë në shtëpi dhe asgjë më shumë nuk ka pas në këtë rast.

Në vazhdim ka theksuar se përpos bashkëshortes së tij që e ka dëgjuar krejt këtë muhabet persona tjerë në ato momente nuk ka pas, ndërsa gjatë këtyre fjalëve që i ka ndërruar me I... ka pas me vete karrocën e dorës dhe tërfurkin të vendosur në karrocë.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sulmi nga neni 181 par.2 të KPRK-së, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave në shqyrtimin gjyqësor dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e tillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Nga dëshmia e të dëmtuarit I.K dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.02.2020;
- Nga dëshmia e dëshmitares D.K dhënë në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.02.2020;
- Nga përmbajtja e raportit të oficerit 2019-CF-1495 i datës 16.08.2019 dhe
- Pjesërisht edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit F.K.

Deklarimi i të dëmtuarit-dëshmitarit

I dëmtuari I.K në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se jeton në fshatin, komuna Ferizaj dhe se shtëpitë me të akuzuarin i kanë në distancë rreth 100 m. krejt kjo ngjarje ka filluar me datën 15.08.2019 gjersa ishte në rrugë me bashkëshorten e tij S.... duke shkuar në Ferizaj, ndërsa F.... kishte qenë duke e përcjellë djalin e tij A.... në një distancë diku rreth 30 m dhe më tu afruar afër, ai e ka goditur me krah në pjesën e majtë të gjoksit edhe pse ka pas mjaftueshëm hapësirë për të kaluar pasi rruga është mbi 4 m. e gjerë dhe pasi e ka goditur dhe ka kaluar rreth 2 metra i është drejtuar atij dhe bashkëshortes së tij me fjalët “ma hankshi b...”, të njëjtit i ka thënë se pse më godite, a je çmendur a çka, dhe ai i është përgjigjur për inat sepse juve duhet me ju rrah dhe me ju shtri për tokë, pas këtyre fjalëve i është drejtuar se ju nuk mundë të më bëni asgjë dhe këqyri punët tuaja dhe për një moment kanë dalë fëmijët e tij dhe e kanë larguar dhe me kaq ka përfunduar kjo ditë. Të nesërmen me datën 16.08.2019 në kohën kur ishte duke shkuar në gjami për të falë namazin e ka parë dhe takuar F.... në rrugën kryesore duke u kthyer nga zyra e vendit, ai kishte një tërfurk në dorë dhe i njëjti vinte në drejtim të tij dhe gjersa mbante tërfurkun në dorë i është drejtuar me fjalët “të nguli në tërfurk” këtë gjersa ishin në distancë rreth 1 m. larg njëri tjetrit, pos këtyre fjalëve ai edhe e ka fyer duke i thënë “o pis, o peder, e fjalë tjera banale” dhe të njëjtit vetëm i ka thënë se krejt këto që po mi thua mua, ashtu je vetë, dhe në këtë moment kanë dalë bashkëshortja e tij dhe fëmijët që ta marrin dhe ta dërgojnë në oborrin e tyre dhe edhe për kundër kësaj që fëmijët e mbanin për trupi ai bënte turr në drejtimin e tij dhe në një moment edhe e ka kap një guri të cilin e ka gjuajtur në drejtim të tij por fatmirësisht nuk ka arrit ta godas.

Në vazhdim i dëmtuari ka theksuar se deri më datë 15.08.2019 raportet i kanë pas të mira, ndërsa që nga ajo datë e këtij raportet e tyre janë dëmtuar pasi në vazhdimësi është provokuar nga i akuzuari pa ndonjë arsye, bile për këtë ka njoftuar gjykatën edhe me datë

20.12.2019 ka pas një rast për të cilin e ka lajmëruar policinë. Në fund ka theksuar se i bashkëngjite ndjekjes penale ndaj të akuzuarit ndërsa kërkesën pasurore-juridike nuk ka parashtruar.

Gjykata për vërtetimin në mënyrë sa më të saktë të asaj se çfarë ka ndodhur ditën kritike në mes të akuzuarit F.K dhe të dëmtuarit I.K në cilësi të dëshmitares ka dëgjuar edhe D.K, bashkëshortja e të akuzuarit F.K e cila është propozuar nga ky i fundit. E njëjta në dëshminë e sajë të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike me datën 16.08.2019 ka qenë prezentë dhe ka parë se çfarë ka ndodhur pasi atë ditë bashkëshorti i sajë F.... diku rreth orës 13:00 ka marrë disa mbeturina me karrocë dore dhe i ka dërguar afër zyrës së vendit për ti djegur, ndërsa ajo ka qëndruar në oborr dhe pas pak kohe gjersa ishte në oborr ka dëgjuar I.... duke i thënë bashkëshorti të sajë peder, pas kësaj me vrap ka dalë në rrugë së bashku me dy fëmijët L.... dhe L.... dhe kur kanë dalë kanë filluar fyerjet e I.... drejtuar F.... me fjalë të ndryshme si peder, lahper etj dhe F.... i është drejtuar I.... se krejt këto që po mi thua ashtu je vetë dhe në një moment I.... i thotë F.... hajde këtu e mos u fsheh pas b... të grave se e marrë tërfurkun dhe kam me ti qitë zorrët në lëndinë, mirëpo për korrektësi I.... e as bashkëshorti i sajë nuk kanë pas tërfurk në dorë dhe pas kësaj I.... ka vazhduar rrugën e tij ndërsa ata kanë hyrë në oborrin e tyre dhe krejt kjo ngjarje ka përfunduar kështu.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Se me datë 16.08.2019, rreth orës 12:50, në fshatin, i pandehuri me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin vëllain e tij I.K, me fjalët “se ka me të ngulur në tërfurk, ju jeni pisa dhe ka me ju ba hakaret”, me ç’rast kjo kanosje tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi duke u bazuar nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit I.K pasi sipas vlerësimit të gjykatës dëshmia e tij ka qenë e saktë dhe objektive, i njëjti natyrshëm ka sqaruar rastin duke përshkruar në mënyrë kronologjike ngjarjen se si ka ndodhur prej momentit kur ka takuar në rrugën e fshatit vëllain e tij tani të akuzuarin F... e deri

sa kanë dalë fëmijët dhe bashkëshortja e këtij të fundit dhe e kanë marrë dhe tërheqë në oborrin e tij.

Gjykata me kujdes të shtuar ka vlerësuar deklaratën e të dëmtuarit-dëshmitarit duke e krahasuar këtë deklaratë edhe me deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datën 21.08.2019 ku në faqen e dytë në pjesën e deklaratës së tij ka përshkruar në hollësi ngjarjen e ndodhur ditën kritike në mes tij dhe të akuzuarit, andaj gjykata si të tilla këtyre deklaratave u fali besimin e plotë.

Gjykata gjithashtu me kujdes të shtuar ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitares D.K, dëshmitare e propozuar nga vetë i akuzuari, mirëpo të njëjtës nuk i fali besimin pasi konsideron se e njëjta ishte subjektive në dëshminë e sajë këtë kur të merret parasysh marrëdhënia e ngushtë familjare në mes sajë dhe të akuzuarin F.K pasi ajo është bashkëshortja e tij dhe për shkak të këtij raporti nuk do ta inkriminonte drejtpërdrejtë për kryerjen e veprës penale. Por mbi gjitha mosbesuese e bënë deklaratën e saj fakti se dëshmitarja pohon se ishte prezent, ka dëgjuar bisedën mes tyre mirëpo që i akuzuari në këtë rast nuk ka pasur fare mjet të fortë (tërfurk) me siguri të lart 100%, kjo e dhënë me saktësi demantohet nga vetë i bashkëshorti saj i akuzuari për faktin se vërteton se ka pas tërfurk dhe karrocë dore.

Nga raporti i oficerit 2019-CF-1495 i datës 16.08.2019 gjykata vërtetoi faktin se ditën kritike me datën 16.08.2019 është lajmëruar një rast që kishte ndodhur në fshatin, komuna Ferizaj dhe atë viktima F.K ishte kanosur dhe fyer nga vëllai i tij F.K, i cili në ato momente kishte edhe një tërfurk në dorë duke i thënë “të godas me tërfurk, ti je narkoman, je peder etj.” viktima ka njoftuar zyrtarin policor se me të dyshuarin nuk kanë raporte të mira tash e 20 vite pasi i njëjti vazhdimisht e provokon në mënyra të ndryshme bile edhe në prezencë të familjeve.

Vlerësimi i mbrojtjes të të akuzuarit

Gjykata çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit F.K se kinse nuk e ka kanosur të dëmtuarin ashtu siç është theksuar në aktakuzë por vetëm se të njëjtit i ka thënë se “mos provoko dhe mos i mësho askujt kur të ecësh rrugës”, mirëpo një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj nga fakti se nga dëshmia e të dëmtuarit I.K u vërtetua pa mëdyshje dhe në mënyrë të

sigurt se ditën kritike me datën 16.08.2019 në kohën e drekës kur i dëmtuari kishte dalë për të shkuar në xhami për të falë namazin, ka parë të akuzuarin F... me një tërfurk në dorë duke qëndruar afër shtëpisë së tij pasi kishte shkuar për të parë terrenin afër zyrës së vendit dhe në momentin kur është kthyer nga zyra e vendit në drejtimin e tij gjersa ka pas tërfurkun në dorë ia ka drejtuar të dëmtuarit dhe i ka thënë se “të nguli në tërfurk” dhe krejt kjo ka ndodhur në një distancë rreth 1 metër larg njëri tjetrit, pos kanosjes së ia ka bërë i njëjti e ka fyer edhe me fjalët se “ti je pis, je peder fjalë tjera fyese.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi ka shqyrtuar aktakuzën dhe kualifikimin juridik të veprës penale kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së, ka vlerësuar se në rastin konkret vepra penale kanosja dhe vepra penale dhuna në familje janë vepra penale të veçanta dhe të njëjtat si tilla janë përshkruar edhe në nene dhe kapituj të veçantë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht kanosja është përshkruar në nenin 181 të KPRK-së ndërsa dhuna në familje në nenin 248 të KPRK-së, andaj gjykata në rastin konkret konstaton se bëhet fjalë vetëm për një veprën penale dhe për këtë sipas detyrës zyrtare ka bërë rikualifikimin e veprës penale kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së në veprën penale kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së pasi vepra penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së konsiderohet vepër e veçantë dhe kjo mundë të merret vetëm si rrethanë rënduese nëse kanosja është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së, për të akuzuarin SH.K, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e Shtetit Luljeta Bilalli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor pas administrimit të provave u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale pasi ky rast ka ndodhur për shkak se i akuzuari me qëllim të frikësimit dhe shkakimit të

ankthit, i është kanosur seriozisht të dëmtuarit I.K me fjalët “kam me të ngul në tërfurk”, ashtu që në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale. Në këtë shqyrtim është dëgjuar i dëmtuari I.K nga i cili në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar fakti se ditën kritike ka ndodhur rasti i kanosjes dhe se gjatë kësaj kanosjeje i akuzuari kishte me vete edhe një mjet pune-tërfurk me të cilin i është drejtuar të dëmtuarit nga distanca në mes tyre rreth 1 m.

Në vazhdim të falës përfundimtare prokurorja e shtetit ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitarja D.K, bashkëshortja e të akuzuarit e e cila ka vërtetuar faktin se në mes tyre ka pas një konflikt ndërsa sa i përket pjesës tjetër të deklaramit të sajë, prokuroria konsideron se gjykata nuk duhet ti falë besimin pasi e njëjta është e njëanshme kur thotë se bashkëshorti i sajë nuk ka pas me vete tërfurkun e që gjatë shqyrtimit gjyqësor vetë i akuzuari ka pranuar se tërfurkun e ka pas me vete, gjithashtu edhe i akuzuari për ti ikur përgjegjësisë penale mundohet që gjithë ngjarjen ta kthej mbi barrën e të dëmtuarit, gjë që gjykata nuk duhet ti falë besimin sepse sikurse të ishte goditur apo kanosur nga i dëmtuari ai do të kishte paraqitur rastin pa asnjë hezitim. Andaj pas vlerësimit të drejtë të të gjitha këtyre provave dhe duke i ndërlidhur në kontestin logjik dhe faktik, prokuroria mbetet pran aktakuzës dhe mbi bazën e këtyre i ka propozuar gjykatës që në këtë çështje penale të merr vendim të drejtë dhe të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptoj dënim i cili do të jetë në proporcion me peshën e veprës penale.

I dëmtuari I.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështet fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ka vërejtje në deklaramin e dëshmitares pasi e njëjta ka qenë subjektive, i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, ndërsa nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari F.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka asgjë se çka të shtoj rreth kësaj çështje përpos asaj se i propozon gjykatës që ta liroj nga aktakuza në mungesë të provave.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin se i

njëjti është mbajtës i familjes, dhe nuk ka dëshmi të ketë qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë penale me vendim të formës së prerë, ndërsa sa u përket rrethanave rënduese gjykata gjeti se kanosja është drejtuar ndaj vëllait si marrëdhënie familjare, peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së gjykata të dëmtuarin I.K me vendbanim në fshatin, komuna Ferizaj, për rezlizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1005/19, dt.11.03.2020

Asistenti

Muedin Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Ilir Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.